

## **Procedura e marrjes dhe shqyrtimit komenteve dhe rekomandimeve**

*Në mbështetje të nenit 15, të ligjit ne.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, palëve të interesuara për të marrë pjesë në konsultimin publik, u jepet kohë e arsyeshme për të dhënë komentet dhe rekomandimet e tyre:*

- brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit paraprak
- brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik
- për akte të rëndësishme afati zgjatet deri në 40 ditë.

Palët e interesuara, komentet dhe rekomandimet e tyre mund ti dërgojnë në *bashkiahimare@yahoo.com* ose me postë në adresën Spile, Himarë.

Komentet dhe rekomandimet, grumbudhohen nga koordinatori i njoftimit dhe konsultimit publik, në mënyrë të strukturuar dhe transparente. Shqyrtimi i tyre, kryhet nga bashkia, e cila vendos për pranimin ose refuzimin e rekomandimeve. Nëse rekomandimet nuk janë pranuar, bashkia paraqet një përmbledhje të arsyeve të mospranimit.